UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor
Prof. Dr. Marjan DEMA

Nr. Prot.: 677
Datë: 19/3/2019

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", pas shqyrtimit të raportit të Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa, me nr. 01/345, dt. 11.02.2019, në mbledhjen e mbajtur më 01.03.2019, mori këtë:

VENDIM

I. Miratohet propozimi i Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa të Senatit të UP-së, me nr. ref. 01/345, i datës 11.2.2019, për REFUZIM si të pabazuar të ankesës së këtyre kandidatëve si në vijim:

- *Fejzullah Hasanit* i është refuzuar ankesa me nr. prot. 5/1, dt. 03.12.2018, si e pabazuar, për zgjedhje në pozitën e profesor asistentit në F. Juridik të UP-së. Mbetet në fuqi njoftimi i senatit me nr. 4/472 dt: 27.11.2018;
- *Mybera Ferizit* i është refuzuar ankesa me nr. prot. 5/181, të dt. 13.12.2018, si e pabazuar, për zgjedhje në thirrjen profesor i rregullt në F. e Mjekësisë. Mbetet në fuqi vendimi i senatit me nr. 4/655 i datës 4.12.2018;
- *Antigona Gërçarit* i është refuzuar ankesa me nr. prot. 5/194, dt. 14.12.2018, si e pabazuar, për zgjedhjen në thirrje profesor asistent në F. e Mjekësisë. Senati vendos që të mbetet në fuqi njoftimi nr. 4/848 dt. 13.12.2018 ;
- *Arjeta Berishës* i është refuzuar ankesa me nr. prot. 3/283, dt. 20.12.2018, si e pabazuar, për zgjedhje në pozitën profesor asistent në F. e Filologjisë, pasi që nuk ka asnjë vlerësim pozitiv nga instancat paraprake;
- *Ilir Muharremit* i është refuzuar ankesa me nr. 5/319, dt. 24.12.2018, si e pabazuar, të ushtruar kundër vendimit të senatit me nr. 4/956 dt: 20.12.2018 për zgjedhje në thirrjen prof. asoc. në F. e Edukimit. Senati vendos që të mbetet në fuqi vendimi për zgjedhjen në pozitën prof. ass. sipas vendimit me nr. 4/956 dt: 20.12.2018;
- *Mybera Ferizit* i është refuzuar ankesa me nr. prot. 5/183, të dt. 13.12.2018, si e pabazuar, kundër kandidates Adelina Aliu, pasi që nuk është palë e përfshirë në konkurse për pozitën e asistentes së prof. asoc. Mybera Ferizi.

II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi do të jetë raporti i Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa, me nr. prot. 01/345, dt. 11.02.2019.

III. Ky vendim është përfundimtar për organet e UP-së dhe hyn në fuqi mënjeherë.

Arsyetim

Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur në datën 01.3.2019, pasi e shqyrtoi raportin e Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa, me nr. prot. 01/345, dt: 11.02.2019, ndaj kandidatëve që kanë ushtruar ankesë kundër vendimit të Senatit të UP-së, që janë: Fejzullah Hasani, Mybera Ferizi, Antigona Gërçari, Teuta Pustina, Arjeta Berisha dhe Ilir Muharremi, ka konstatuar se ankesat janë të pabazuara, përkatësisht të përmendurit nuk i plotësojnë kushtet sipas kritereve të përcaktuara nga Senati i UP-së dhe akteve tjera juridike, të cilat i

merr për bazë Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" me rastin e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe emërimit të personelit akademik.
Bazuar në argumentet e sipërshënuara, Senati i UP-së konstatoi se mbetet në fuqi vendimi/njoftimi i Senatit të UP-së për palët e përmendura në raportin e ankesave dhe parashtresave, që mban nr. prot. 01/345, dt. 11.02.2019, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Zyrtarit ligjor të UP-së;
3. Parashtrueseve të ankesës;
4. Zyrës për Çështje Akademike;
5. Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa;
6. Uebfaqes së UP-së.

Senati i Universitetit të UP-së

Prof. dr. Marjan Dema - rektor